



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Divizionit të Mbikëqyrjes së Tregjeve dhe FinTech-ve, Kripto-aseteve dhe Inovacionit
Grada e pozitës:	P03 -1
Pozita:	E përhershme
Departamenti:	Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregjeve, IMF, IFJB, IP dhe IPE
Divizioni:	Divizionit të Mbikëqyrjes së Tregjeve dhe FinTech-ve, Kripto - aseteve dhe Inovacionit
I raporton:	Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregjeve, IMF, IFJB, IP dhe IPE

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Harton, përditëson dhe zbaton politikat dhe aktet rregullatore për mbikëqyrjen e institucioneve FinTech, kripto-aseteve dhe tregjeve financiare, nën udhëzimin e drejtpërdrejtë të mbikëqyrësit, në përputhje me mandatin dhe strategjinë e BQK-së;
- Monitoron zhvillimet në tregjet financiare dhe teknologjike dhe identifikon rreziqet potenciale që lidhen me aktivitetet FinTech, kripto-asetet, instrumentet financiare dhe modelet e reja të biznesit;
- Analizon dhe vlerëson modelet e biznesit të kompanive FinTech, përfshirë shërbimet digjitale financiare, platformat teknologjike dhe përdorimin e inovacioneve në ofrimin e shërbimeve financiare;
- Përgatit dhe propozon qasje dhe plane mbikëqyrëse bazuar në profilin e rrezikut të subjekteve FinTech dhe ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, duke rekomanduar shpeshhtësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe monitorimit nga jashtë;
- Merr pjesë në proceset e ekzaminimit dhe vlerësimit mbikëqyrës të institucioneve jo-banka, përfshirë analizën e raporteve rregullatore, vlerësimin e rrezikut dhe ndjekjen e masave korrigjuese;
- Mbështet procesin e licencimit, autorizimit dhe vlerësimit paraprak të institucioneve FinTech dhe ofruesve të shërbimeve të kripto-aseteve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore;
- Kontribuon në zhvillimin dhe përmirësimin e kornizës rregullative për inovacionin financiar, përfshirë teknologjitë blockchain, paratë digjitale, stablecoins dhe inteligjencën artificiale;

- Analizon ndikimin e inovacioneve financiare dhe teknologjike në stabilitetin financiar, integritetin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit;
- Bashkëpunon me departamentet e tjera të BQK-së dhe institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare lidhur me zhvillimet në FinTech dhe krypto-asete;
- Përgatit analiza, raporte dhe materiale profesionale lidhur me zhvillimet e tregut, rreziqet emergjente dhe trendet në inovacionin financiar;
- Mbështet iniciativat për zhvillimin e tregut financiar dhe inovacionit të përgjegjshëm, përfshirë iniciativa si sandbox rregullator ose projekte pilot, sipas politikave të BQK-së;
- Ndihmon në hartimin dhe rekomandimet për rregullativën sekondare plotësuese të Ligjit të Tregut Financiar, përfshirë rregullat për emetim, listim, tregtim, de-listim dhe transparencë të instrumenteve financiare në tregje të rregulluara dhe jashtë bursës (OTC);
- Mbikëqyr (ekzaminon) institucionet e licencuara dhe aktivitetin në tregun e rregulluar, përfshirë mbikëqyrjen e infrastrukturës së tregut (settlement dhe clearing);
- Harton rregullat dhe praktikrat për qeverisjen korporative, menaxhimin e rrezikut dhe politikat e investimit për akterët që emetojnë letra me vlerë dhe subjektet e tjera të mbikëqyrura;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve, kërkesave nga ekzaminimet në vend, masave detyruese të shqiptuara ndaj institucioneve të mbikëqyrura;
- Ofron udhëzime strategjike për subjektet që përdorin Blockchain, Inteligjencë Artificiale dhe teknologji të reja, duke balancuar inovacionin me stabilitetin financiar;
- Drafton raporte në kuadër të Departamentit mbi tendencat, sfidat dhe zhvillimet rregullatore në fushën e FinTech, krypto-aseteve dhe tregjeve financiare;
- Përgatitë raportet individuale dhe të konsoliduar në kuadër të Divizionit;
- Ndihmon në përpilimin e politikave mbikëqyrëse, rregulloreve, manualeve dhe procedurave tjera të punës, përfshirë IFJB, IP, dhe EMI;
- Detyra tjera të përcaktuara nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë, shkencave kompjuterike, shkencave teknike, matematikës ose në fusha të tjera që ndërlidhen me përgjegjësitë e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së, në linkun: [Departamentet e mbikqyrjes financiare - BQK](#);
- Të ketë së paku gjashtë (6) vite përvojë profesionale pune në sektorin financiar ose në fusha që ndërlidhen me përgjegjësitë e Divizionit të Mbikëqyrjes së Tregjeve, FinTech-ve, Kripto-aseteve dhe Inovacionit, prej të cilave së paku tre (3) vite përvojë menaxheriale në sektorin financiar ose në fusha që ndërlidhen me përgjegjësitë e këtij Divizioni, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së, në linkun: [Departamentet e mbikqyrjes financiare - BQK](#) .
- Preferohen certifikime nga fusha e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e vendit të punës.
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe prezantimi.
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes;
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese), e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku gjashtë (6) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- **Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku gjashtë (6) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **07 korrik 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQKsë. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh